



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo - Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

---

Legjislatura VIII  
Sesioni Vjeshtor

Kryesia e Kuvendit  
P-093

Prishtinë, më 23 shtator 2024, ora 11:23  
Ndërtesa e Kuvendit, salla C-301

PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË KRYESISË SË KUVENDIT, E MBAJTUR MË 23 SHTATOR 2024

**Në mbledhje morën pjesë:** Glauk Konjufca, kryetar i Kuvendit; Saranda Bogujevci, Enver Hoxhaj dhe Bahrim Shabani, nënkryetarë të Kuvendit.

**Mungoi:** Kujtim Shala, nënkryetar i Kuvendit.

**Nga grupet parlamentare në mbledhje morën pjesë:** Mimoza Kusari-Lila, Abelard Tahiri, Besnik Tahiri dhe Enis Kervan.

**Mungoi:** Arben Gashi, kryetar i GP të LDK-së.

**Në mbledhje mori pjesë edhe** zëvendësuesi i Sekretarit të Përgjithshëm të Kuvendit, Arben Loshi.

**Në mbledhje ishin të pranishëm:** Staf i përgjegjës i Administratës së Kuvendit për mbështetje Kryesisë së Kuvendit, si dhe nga Kabineti i kryetarit të Kuvendit, nga grupet parlamentare dhe nga organizatat.

Mbledhjen e kryesoi Glauk Konjufca, kryetar i Kuvendit.

Me propozim të kryetarit, Kryesia e plotësoi rendin e ditës me një (1) pikë për shqyrtim nga Kryesia e Kuvendit.

Pastaj, Kryesia i zhvilloi punimet me këtë:

Rend dite

1. Pika e papërfunduar nga seanca e jashtëzakonshme, e mbajtur më 28 mars 2024,
2. Seanca plenare, e shtyrë nga data e paraparë që të mbahet më 24 maj 2024,
3. Pikat e papërfunduara nga seanca plenare, e mbajtur më 12 shtator 2024,
4. Propozimi i rendit të ditës për seancën plenare të radhës,
5. Shqyrtimi i propozimeve dhe i kërkesave.

## **1. Pika e papërfunduar nga seanca e jashtëzakonshme, e mbajtur më 28 mars 2024**

## **2. Seanca plenare, e shtyrë nga data e paraparë që të mbahet më 24 maj 2024**

Përsëri nuk u vendos për datën e mbajtjes së seancave të lartshënuara në pikat 2 dhe 3.

## **3. Pikat e papërfunduara nga seanca plenare, e mbajtur më 12 shtator 2024**

Kryetari, pas diskutimeve, me konsensus, vendosi që vazhdimi i seancës plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës, me pikat e papërfunduara, të mbahet të enjten, më 26 shtator 2024, në orën 10:00, me këtë:

### *Rend dite*

- 1. Miratimi i procesverbaleve nga seancat e mëparshme,*
- 5. Emërimi i shtatë (7) anëtarëve të Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturorë,*
- 6. Votimi i Projektligjit nr. 08/L-309 për ratifikimin e Marrëveshjes së financimit, për programin e parë për “Financimin e politikave zhvillimore për efektivitetin fiskal, konkurrueshmërinë dhe rritjen e gjelbër”, në mes të Republikës së Kosovës e përfaqësuar nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve dhe Asociacionit Ndërkombëtar për Zhvillim,*
- 7. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 08/L-313 për ratifikimin e amendamentimit të Marrëveshjes për anëtarësimin e Republikës së Kosovës në Fondin Monetar Ndërkombëtar dhe organizatat e grupit të Bankës Botërore,*
- 8. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 08/L-314 për ratifikimin e Marrëveshjes së kredisë mes të Republikës së Kosovës dhe Bankës Evropiane për Investime për Projektin Energjia diellore fotovoltaike në KEK - Porta Globale,*
- 9. Votimi në lexim të dytë i Projektligjit nr. 08/L-212 për shëndetin riprodhues dhe fertilizim të asistuar mjekësor,*
- 10. Votimi në lexim të dytë i Projektligjit nr. 08/L-294 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 08/L-197 për zyrtarët publikë,*
- 11. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 08/L-287 për Këshillin e Sigurisë të Republikës së Kosovës,*
- 12. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 08/L-275 për rrugët,*
- 13. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 08/L-290 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 08/L-013 për të drejtat pronësore të shtetasve të huaj në Republikën e Kosovës,*
- 14. Votimi në parim i Projektligjit nr. 08/L-266 për gjendjen civile,*
- 15. Votimi në parim i Projektligjit nr. 08/L-300 për provimin e maturës shtetërore,*
- 16. Shqyrtimi i parë i Projektligjit nr. 08/L-306 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 05/L-132 për automjete,*
- 17. Shqyrtimi i parë i Projektligjit nr. 08/L-311 për menaxhimin e resurseve ujore,*
- 18. Shqyrtimi i Programit Kombëtar për Integrim Evropian 2024-2028,*
- 19. Votimi i Projekt-rezolutës për adresimin e gjetjeve të Raportit të Departamentit Amerikan të Shtetit-DASH,*
- 20. Shqyrtimi i Projekt-Deklaratës për raportet e Republikës së Kosovës me Shtetet e Bashkuara të Amerikës,*
- 21. Shqyrtimi i Projekt-Rezolutës për adresimin e çështjes së emigrimit të qytetarëve nga Republika e Kosovës,*
- 22. Shqyrtimi i Projekt-Rezolutës për tërheqjen e tri (3) projektligjeve nga shqyrtimi në Kuvend,*
- 23. Shqyrtimi i Projekt-Rezolutës për arratisjen e personave të dënuar - degradimi i institucioneve të sigurisë,*

24. *Shqyrtimi i Raportit me rekomandime për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit nr. 05/L-090 për sponsorizime në fushën e kulturës, rinisë dhe sportit, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-116,*
25. *Shqyrtimi i Propozim-rezolutës për vlerësimin e punës së Agjencisë për Informim dhe Privatësi për vitin 2022,*
26. *Shqyrtimi i Raportit të Performansës së ndërmarrjeve publike për vitin 2022,*
27. *Raportimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës për progresin mbi zbatimin e Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm dhe reflektimin e Agjendës Transformuese të Kosovës në buxhet dhe politika qeveritare,*
28. *Themelimi i Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për dy (2) anëtarë të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës, prej tyre, një nga komuniteti shqiptar dhe një nga komuniteti serb.*

#### **4. Propozimi i rendit të ditës për seancën plenare të radhës**

Kryetari nuk vendosi për mbajtjen e seancë së re plenare, me qëllim të pritjes së raporteve tjera nga komisionet parlamentare.

#### **5. Shqyrtimi i propozimeve dhe i kërkesave**

##### *1. Kërkesa e deputetit Rashit Qalaj për lejimin e udhëtimit zyrtar në Argjentinë*

Kryesia, në lidhje me kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

#### **V E N D I M**

1. Deputetit të Kuvendit të Republikës së Kosovës, Rashit Qalaj, i lejohet udhëtimi zyrtar në Buenos Aires (Argjentinë), prej datës 23 deri më 26 tetor 2024.
2. Të gjitha shpenzimet e udhëtimit (transportit), të akomodimit (qëndrimit), shpenzimet tjera eventuale dhe mëditjet për të lartshënuarin në pikën 1 (një) të këtij vendimi mbulohen nga buxheti i Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Kryetari kërkoi nga grupet tjera parlamentare që sa më parë t'i propozojnë deputetët për udhëtimin zyrtar në Argjentinë.

##### *2. Kërkesa e deputetes Eliza Hoxha për lejimin e udhëtimit zyrtar në Turqi*

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

#### **V E N D I M**

1. Deputetes së Kuvendit të Republikës së Kosovës, Eliza Hoxha, i lejohet udhëtimi zyrtar në Stamboll (Turqi), prej datës 26 deri më 29 shtator 2024.

2. Mëditjet për të lartshënuarën në pikën 1 (një) të këtij vendimi mbulohen nga buxheti i Kuvendit të Republikës së Kosovës, ndërsa shpenzimet e udhëtimit (biletës) dhe akomodimit (qëndrimin) mbulohen nga organizatori (Fondacionit Friedrich Naumann).

*3. Kërkesa e deputetes Fitore Pacolli-Dalipi për lejimin e udhëtimit zyrtar në Kroaci*

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

#### V E N D I M

1. Deputetes së Kuvendit të Republikës së Kosovës, Fitore Pacolli-Dalipi, i lejohet udhëtimi zyrtar në Zagreb (Kroaci), prej datës 27 deri më 29 shtator 2024.

2. Mëditjet për të lartshënuarën në pikën 1 (një) të këtij vendimi mbulohen nga buxheti i Kuvendit të Republikës së Kosovës.

*4. Kërkesa e kryetares së Komisionit për Integrim Evropian, Rrezarta Krasniqi, për lejimin e udhëtimit zyrtar në Gjermani*

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

#### V E N D I M

1. Deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës: Rrezarta Krasniqi, Fjolla Ujkani, Agon Batusha dhe Blerta Deliu-Kodra, u lejohet udhëtimi zyrtar në Berlin (Gjermani), prej datës 8 deri më 10 tetor 2024.

2. Mëditjet për të lartshënuarit në pikën 1 (një) të këtij vendimi mbulohen nga buxheti i Kuvendit të Republikës së Kosovës, ndërsa shpenzimet e udhëtimit dhe akomodimit mbulohen nga organizatori (Instituti për Demokraci dhe Shoqëri Civile, Shkup).

Po ashtu, në lidhje me përbërjet e delegacioneve të komisioneve parlamentare në udhëtimet zyrtare, Kryesia nxori këtë:

#### P Ë R F U N D I M

1. Kërkohet nga komisionet parlamentare që gjatë vizitave zyrtare (udhëtimeve zyrtare) në delegacione t'i përfshijnë edhe deputetët nga radhët e komuniteteve, të cilat nuk janë shumicë.

2. Komisionet parlamentare të kërkojnë nga institucionet dhe organizatat nikoqire që të ftohen edhe deputetët e komuniteteve që nuk janë shumicë.

*5. Kërkesa e kryetares së Komisionit për Integrim Evropian, Rrezarta Krasniqi, për lejimin e udhëtimit zyrtar në Hungari*

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

## V E N D I M

1. Deputeteve të Kuvendit të Republikës së Kosovës: Rrezarta Krasniqi dhe Fjolla Ujkani, u lejohet udhëtimi zyrtar në Budapest (Hungari), prej datës 27 deri më 30 tetor 2024.
2. Të gjitha shpenzimet e udhëtimit (biletës), të akomodimit (qëndrimit) dhe mëditjet për të lartshënuarat në pikën 1 (një) të këtij vendimi mbulohen nga buxheti i Kuvendit të Republikës së Kosovës.
6. *Kërkesa e kryetares së Komisionit për Integrim Evropian, Rrezarta Krasniqi, për zëvendësimin e deputetes në udhëtimin zyrtar në Shqipëri*

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

## V E N D I M

për ndryshimin e Vendimit nr. 08-V-851, datë 9. 9. 2024

Pika një (1) e Vendimit nr. 08-V-851, datë 9. 9. 2024, ndryshohet, si vijon:  
Deputeteve të Kuvendit të Republikës së Kosovës: Time Kadrijaj dhe Fjolla Ujkani, u lejohet udhëtimi zyrtar në Vlorë (Shqipëri), prej datës 10 deri më 13 shtator 2024.

7. *Kërkesa për mbulimin e shpenzimeve të vizitës zyrtare në Kosovë të kryetares së Kuvendit të Shqipërisë*

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

## V E N D I M

Me rastin e vizitës zyrtare të kryetares së Kuvendit të Shqipërisë, znj. Elisa Spiropali me delegacion, të realizuar në Republikën e Kosovës, nga data 10 deri më 11 shtator 2024, nga buxheti i Kuvendi të Republikës së Kosovës mbulohen shpenzimet (sipas faturave), sipas kërkesë nr. 08/5707/Do-2516, datë 13. 9. 2024, si në vijim:

- Shpenzimet e akomodimit për krejt delegacionin, në shumën prej 760,00 euro,
- Shpenzimet e drekës për delegacionin, në shumën prej 654,00 euro,
- Shpenzimet e drekës për stafet përcjellëse, në shumën prej 480,00 euro,
- Shpenzimet e dhuratës për kryetaren e Kuvendit të Shqipërisë, në vlerën prej 55,00 euro,
- Shpenzimet e bufesë për takimet me kryetarët e grupeve parlamentare dhe me Grupin e Grave Deputete, në shumën prej 23,50 euro.

8. *Kërkesa për mbulimin e shpenzimeve të drekës zyrtare*

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

## V E N D I M

Mbulohen shpenzimet në shumën prej 50,70 euro (sipas faturës) të drekës zyrtare të shtruar nga nënkryetarja e Kuvendit, Saranda Bogujevci, për ambasadorin e Mbretërisë së Bashkuar dhe Ministrin e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Hajrulla Çeku.

*9. Konfirmimi i Vendimit për deputetin Gazmend Gjyshinca për lejimin e udhëtimit zyrtar në Kanada*

Kryetari njoftoi se deputeti Gazmend Gjyshinca e ka anuluar udhëtimin zyrtar për në Kanada.

*10. Kërkesa e Komisionares Parlamentare për Forcën e Sigurisë së Kosovës, Remzie Zeqiraj, për lejimin e udhëtimit zyrtar në Gjermani*

Kryetari deklaroi se çështja e udhëtimeve zyrtare të Komisionares Parlamentare për Forcën e Sigurisë së Kosovës nuk është e rregulluar, por duhet t'i lejohet udhëtimi zyrtar i kërkuar.

Pastaj, Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

## V E N D I M

1. Komisioneres Parlamentare për Forcën e Sigurisë së Kosovës, Remzie Zeqiraj, i lejohet udhëtimi zyrtar në Berlin (Gjermani), prej datës 30 shtator deri më 2 tetor 2024.
2. Mëditjet për të lartshënuarën në pikën 1 (një) të këtij vendimi mbulohen nga buxheti i Kuvendit të Republikës së Kosovës, ndërsa shpenzimet e udhëtimit (biletës) dhe akomodimit (qëndrimit) mbulohen nga organizatori (Qendra e Gjenevës për Qeverisjen e Sektorit të Sigurisë).

*11. Kërkesa e kryetares së Komisionit për Mjedis, Ushqim, Bujqësi, Planifikim dhe Zhvillim, Fitore Pacolli-Dalipi për lejimin e udhëtimit zyrtar në Gjermani*

Kryesia, në pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

## V E N D I M

1. Deputetes së Kuvendit të Republikës së Kosovës, Fitore Pacolli-Dalipi, i lejohet udhëtimi zyrtar në Berlin (Gjermani), prej datës 1 deri më 2 tetor 2024.
2. Mëditjet për të lartshënuarën në pikën 1 (një) të këtij vendimi mbulohen nga buxheti i Kuvendit të Republikës së Kosovës, ndërsa shpenzimet e udhëtimit dhe të akomodimit mbulohen nga organizatori (Këshilli Evropian për Marrëdhënie me Jashtë).

Në fund, nënkryetarja e Kuvendit, Saranda Bogujevci i shtroi për diskutim dy çështje:

- *Ftesa për Këshillin e Evropës për vëzhgimin e Zgjedhjeve të Përgjithshme në Republikën e Kosovës, dhe*

- Çështja e mandatit të delegacioneve të përhershme të Kuvendit të Republikës së Kosovës për përfaqësim në organizata ndërkombëtare me rastin e zgjedhjeve, që do të mbahen më 9 shkurt 2025.

Diskutimi i nënkryetares së Kuvendit, Saranda Bogujevci, për çështjet e lartshënuara është dhënë në transkript.

Pastaj, Kryesia në lidhje me çështjet e lartshënuara të shtruara nga nënkryetarja e Kuvendit, Saranda Bogujevci, mori këto vendime:

I.

V E N D I M

Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës ta ftojë Këshillin e Evropës që t'i vëzhgojë Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, që do të mbahen më 9 shkurt 2025.

II.

V E N D I M

Delegacionet e përhershme të Kuvendit të Republikës së Kosovës për përfaqësim në organizata ndërkombëtare mbeten aktive deri në përfundimin e mandatit të Legjislaturës VIII.

Kryetari e mbylli mbledhjen në orën 11:48 minuta.

**Glauk Konjufca**

---

Kryetar i Kuvendit

*Procesverbalin e hartoi:*

*Drejtoria për Çështje Plenare dhe Procedurale*